



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

**Lënda:** Kthim përgjigje

**REDAKSISË MCN TV**  
**ZNJ. A.LL.**

E nderuar { ... }

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e redaksisë suaj, në përgjigje të kërkesës për informacion të datës 02.04.2021, regjistruar me numër rendor 18, datë 02.04.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1411 Prot., datë 02.04.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në përmbushje të detyrave kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si një ndër institucionet e qeverisjes të sistemit gjyqësor, me kompozim dhe funksione të reja, përgjatë rrugëtimit të tij 2 vjeçar, përjetoi sfida të qenësishme, për të menaxhuar një sistem gjyqësor në riorganizim dhe për të garantuar një drejtësi efikase dhe pa vonesa për qytetarët. Gjatë dy viteve të ekzistencës së tij, pavarësisht problematikave të mbartura të sistemit gjyqësor dhe fatkeqësitë natyrore shkaktuara nga tërmeti i fund vitit 2019 dhe pandemia globale Covid-19, në vitin 2020, Këshilli arriti të ruaj ritmin e veprimtarisë së tij në kuadër të përmbushjes së kompetencave kushtetuese, ligjore edhe strategjike. Në veprimtarinë e tij, Këshilli është udhëhequr nga parime themelore të tilla si pavarësia, integriteti, profesionalizmi, paanshmëria dhe llogaridhënia, në funksion të së cilave, gjatë dy viteve, shënjohe disa zhvillime pozitive, më konkretisht:

Gjatë dy viteve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka organizuar 145 mbledhje plenare dhe ka miratuar 969 vendime. Më konkretisht gjatë vitit 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka organizuar 57 mbledhje plenare dhe ka miratuar 315 vendime, ndërsa gjatë vitit 2020 Këshilli ka organizuar 88 mbledhje plenare dhe ka miratuar 654 vendime. Vlen të theksohet se vendimmarrje e KLGJ është rritur në mënyrë cilësore dhe sasiore duke marrë në konsideratë që institucioni pararendës, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për të njëjtin hark kohor miratonte rreth 54 vendime. Kjo tregon një rritje prej 6-fish të numrit të vendimmarrjeve të Këshillit në raport me pararendësin e tij.

Në përmbushje të detyrave kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor po vijon punën intensive për përmirësimin e administrimit të gjykatave, emërimin e gjyqtarëve të rinj dhe zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe rritjen e transparencës në vendimmarrje, duke u përqendruar në konsolidimin e gjykatave speciale për korrupsionin dhe krimin e organizuar, rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me Gjykatën e Lartë, KLGJ ka miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe rregulloret që i hapën rrugë fillimit të dy proceseve paralele që lidhen me rekrutimin e juristëve të spikatur dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve brenda sistemit. Përveç plotësimit të kriterëve ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedurat e vlerësimit të kandidatëve për emrim në Gjykatën e Lartë është e lidhur ngushtë me përmbylljen si të procesit të rivlerësimit kalimtar të

gjqtarëve (Vettingut) dhe me vlerësimin periodik etiko-profesional të tyre (së paku 2 vlerësime). Këto të fundit konsiderohen si një parakusht për procedurat e ngritjes në detyrë. Procesi i rivlerësimit kalimtar është ende i pa përfunduar për disa kandidatë. Ndërkohë KLGJ, përmes Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është i angazhuar në kryerjen e një vlerësimi të shpejtë për 21 kandidatëve nga të ardhur nga sistemi gjyqësor. Paralelisht, Këshilli po përfundon procesin e vlerësimit të kandidatit të katërt nga radhët e juristëve të spikatur. Ndër të tjera, për të mundësuar funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të Gjykatës së Lartë, KLGJ-ja miratoi rregullat standarde për organigramën e Gjykatës së Lartë, përfshirë përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi.

Tashmë shtatë gjyqtarë ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Lartë, duke kthyer kështu funksionalitetin e saj pas një periudhe dy vjeçare. Vlen të përmendet se kohët e fundit, Këshilli, me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë, ka hartuar një udhëzues për efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe zvogëlimin e çështjeve të prapambetura. Ky dokument, i cili parashikon një sërë masash konkrete, synon të adresojë situatën e krijuar në këtë gjykatë për shkak të numrit të konsiderueshëm të çështjeve të prapambetura.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur dhe rihapur procedurat për ngritjen në detyrë, për 20 pozicione, në të 6 gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për të cilat kanë kandiduar 26 gjyqtarë. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë verifikimin paraprak të plotësisimit nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit, si dhe është në proces për vlerësimin etik dhe profesional për të gjithë kandidatët. Vendimet përkatëse gjenden në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rubrikën “vendime”, në kategorinë “akte administrative individuale”:

<http://klgj.al/akte-administrative-individuale>

Në ndryshimet kushtetuese, të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, (të ndryshuar), ndër të tjera, në nenin 135 të tij, është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në të cilën do gjykohen veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Më konkretisht akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo edhe akuzat ndaj ish-funksionarëve të mësipërm. Më 18 dhjetor 2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor mori një ndër vendimet më të rëndësishme gjatë veprimtarisë tij, siç është miratimi i vendimit nr. 286 për vënien në funksionim të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky hap i ndërmarrë nga KLGJ-ja në vazhden e jetësimit të reformës në drejtësi dhe si një përpjekje konkrete ndaj luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar. Ky proces i krijimit të gjykatave të posaçme u koordinua ngushtë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë në mënyrë që të dy institucionet - gjykatat e posaçme dhe prokuroria e posaçme - të krijoheshin dhe të fillonin veprimtarinë gjyqësore në të njëjtën kohë.

Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, filloi funksionimin e saj me 6 gjyqtarë në detyrë, ndërsa numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 11, e përcaktuar kjo me Vendimin e Këshillit nr.286, datë 18.12.2019, bazuar në numrin minimal që përcakton Ligji nr. 98/2016<sup>1</sup> “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>1</sup> shkronja “ç”, pika 4, e nenit 15.

Pranë kësaj gjykate, pas emërimeve në Gjykatën e Lartë, ushtronin detyrën vetëm 3 nga 6 gjyqtarë që nisën fillimisht detyrën më 18.12.2019. Me qëllim plotësimin e kësaj gjykate, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka hapur procedurën për plotësimin e vendeve vakante për 6 pozicione të lira, ku konstatohet se ka pasur një numër shumë të vogël kandidimesh. Për 3 (tre) nga 6 pozicionet e hapura ka pasur vetëm nga një kandidatë për pozicion. Për këto tre kandidatë aplikant Këshilli ka kryer me urgjencë të gjitha procedurat ligjore të si dhe një verifikim të thelluar të kushteve dhe kriterëve të emërimit. Për rrjedhojë në mbledhjen e datës 29.03.2021, Këshilli vendosi miratimin e renditjes së kandidatëve për tre pozicionet e lira. Bazuar në renditjen e tyre sipas kriterëve ligjore, Këshilli vendosi në mbledhjen e datës 02.04.2021 (vendim nr.140) ngritjen në detyrë të njërit prej tyre për një pozicion ndërkohë që vijojnë dhe procedurat për ngritjen në detyrë, për dy pozicionet e tjera. Pra, aktualisht kjo gjykatë funksionon me 4 gjyqtarë dhe brenda muajit prill është e pritshme që të plotësohet dhe me 2 gjyqtarë të tjerë duke e çuar numrin e gjyqtarëve në 6.

Për 3 (tre) pozicionet e tjera për të cilat nuk ka pasur kandidatë është parë e nevojshme që procedurat të shpallen dhe rihapen disa herë. Për më tepër shih linkun: <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-date-2-prill-2021/>

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në fillim të ushtrimit të veprimtarisë së saj kanë qenë në detyrë 11 gjyqtarë, ndërsa numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të kësaj gjykate është 16 dhe kjo përcaktuar me Vendimin e Këshillit nr. 286, datë 18.12.2019, në numrin minimal që përcakton Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Për funksionimin e plotë të kësaj gjykate, Këshilli ka shpallur fillimisht 5 pozicione të lira. Duke qenë se vetëm për një pozicion kishte një kandidat dhe për 4 pozicionet e tjera të lira nuk kishte aplikime Këshilli ka vendosur përsëri shpallen dhe rihapjen e vakancave. Në kushtet kur përsëri nuk kishte asnjë kandidatë për këto 4 pozicione si dhe pas krijimit të një pozicioni tjetër të lirë si pasojë e shkarkimit të një gjyqtari nga KPK, Këshilli njoftoi 5 pozicione të lira (rihapi 4 pozicione dhe hapje 1 pozicion), ku për njërin prej tyre kandidoi një kandidat.

Pra, aktualisht për dy pozicione pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka nga një kandidat ndërsa për 4 pozicione nuk ka asnjë kandidatë. Një nga kandidatët pritet që të caktohet në detyrë brenda muajit prill. Ndërkohë që për kandidatin tjetër ende nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar dhe kjo pavarësisht se për të është kërkuar trajtimi me përparësi i procedurës së rivlerësimit kalimtar. Duke qenë se ky proces nuk ka mbaruar ende dhe Këshilli është në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me qëllim përfundimin e procedurës së emërimit.

Sa i përket elementëve të rinj të emëruar rishtazi në sistem, KLGJ gjatë dy viteve ka emëruar 44 gjyqtarë, të cilët kanë përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës. Kështu gjatë vitit 2019, u emëruan në detyrë 10 magjistratë që u diplomuan në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa në vitin 2020 u emëruan 34 magjistratë. Në përgjigje të nevojave të rritura të sistemit gjyqësor, për të zbutur ndikimin e procesit të rivlerësimit kalimtar (vetting-ut), Këshilli vendosi të rrisë numrin e kandidatëve për magjistratë në profilin gjyqësor në 28 për vitin akademik 2019-2020 dhe në 40 për 2020-2021.

KLJGJ, me qëllim maksimizimin e përdorimit efikas të burimeve njerëzore, gjatë dy viteve Këshilli trajtoi 1474 kërkesa nga gjykatat për të plotësuar trupat gjyqësore duke caktuar rreth 1719 gjyqtarë për të gjykuar çështjet gjyqësore në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin. Nga këto, 1209 caktime gjyqtarësh janë kryer për vitin 2019 dhe 874 caktime të tjera për vitin 2020.

Në mbështetje të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, KLGJ<sup>2</sup>, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjatë dy viteve ka organizuar punën duke dorëzuar pranë KPK dhe ONM rreth 300 raporte vlerësimi profesional për 300 subjekte rivlerësimi kalimtar nga 466 subjekte të regjistruar për këtë proces në fillim. Më konkretisht për vitin 2020, janë organizuar 148 shorte dhe janë dorëzuar 72 raporte në KPK dhe OMN.

Për herë të parë, Këshilli po zbaton, përmes një pakete aktesh specifike nënligjore, procesin e reformës së administratës civile gjyqësore. Ky është një proces transformimi 360 gradë, në funksion të garantimit të një administrate gjyqësore sa më profesionale, të qëndrueshme dhe me integritet të lartë në ushtrimin e funksioneve publike. Më konkretisht, KLGJ ka miratuar aktet nënligjore të nevojshme në lidhje me emërimet dhe ngritjet në detyrë në administratën gjyqësore, bazuar në kriteret dhe standardet e meritokracisë dhe transparencës. Këshilli miratoi gjithashtu rregullat dhe procedurat për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve aktualë të gjykatave dhe për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për kancelar, këshilltar dhe ndihmës ligjor. Për më tepër, Këshilli miratoi krijimin e njësive të shërbimit juridik brenda gjykatave të apelit, duke kompletuar kështu një aspekt të rëndësishëm të funksionimit të këtyre gjykatave, në mënyrë që të rritet efikasiteti i tyre dhe të zvogëlohet numri i çështjeve të prapambetura.

Përveç veprimtarisë së mësipërme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke qenë i vetëdijshëm për situatën e krijuar dhe mungesën e burimeve njerëzore në gjykata veçanërisht në nivelin e gjykatave të apeleve, me qëllim adresimin e problematikave, ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë (në shtator të vitit 2020) projekt-propozimin për miratimin e hartës e re gjyqësore. Aktualisht, ky produkt i përgatitur nga një grup ndër-institucional pune është në proces konsultimi me Ministrinë e Drejtësisë e cila ka një qasje tjetër në lidhje me rikonfigurimin e gjykatave në rang vendi. Me miratimin e hartës së re gjyqësore, veç minimizimit të kostove dhe pasojave që sjell rivlerësimi kalimtar, KLGJ-ja synon rritjen e efikasitetit të gjykatave, përmirësimin e shpejtësisë së gjykimit dhe aksesit në drejtësi të qytetarëve.

Këshilli si organ i ri qeverisës i gjyqësorit, i ka kushtuar dhe i kushton një rëndësi shumë të madhe si transparencës në vendimmarrje ashtu dhe ofrimit të shpejtë dhe të saktë të informacionit për publikun dhe kjo e mundur përmes platformave të ndryshme të komunikimit. Organizimi i mbledhjeve të hapura plenare, miratim i programit institucional të transparencës, hartimi i strategjisë së komunikimit, caktimi i Anëtarit të KLGJ-së përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, si dhe caktimi i gjyqtarëve për median në 8 gjykatat e juridiksionit të apelit. Gjithashtu, KLGJ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Projektin “Drejtësi për të gjithë” - USAID, ka punuar për të dizenuar dhe bërë aktive faqen e re të internetit: [www.klgj.al](http://www.klgj.al). Kjo faqe e re përveç se përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, synon vendosjen e marrëdhënieve proaktive, transparente e informuese me publikun dhe median. Ajo krahas informacioneve mbi rolin, funksionet, kompetencat dhe strukturën organizative të Këshillit jep informacion pothuajse në kohë reale të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së KLGJ-së nëpërmjet rubrikave dedikuara vendimeve, aktiviteteve dhe njoftimeve për shtyp. Përmes faqes së re të internetit është mundur publikimi online i regjistrimeve audio të mbledhjeve të Këshillit, gjë e cila për arsye teknike nuk ishte e mundur në faqen e mëparshme, duke rritur kështu transparencën mbi vendimmarrjet e Këshillit. Faqja aktuale është një zgjidhje e përkohshme, pasi KLGJ-ja po punon me partnerët ndërkombëtarë për zhvillimin e një Portali gjyqësor, i cili do të sigurojë standarde bashkëkohore dhe do të shërbejë për një akses të

<sup>2</sup> Së bashku me ish-KLD

menjëhershëm në veprimtarinë, sfidat dhe rezultatet e Këshillit dhe gjykatave në të gjithë vendin.

Në lidhje me korrupsionin në gjykata dhe spastrimin e të korruptuarve nga sistemi, prej datës 01.02.2020 është ngritur dhe funksionon Inspektori i Lartë të Drejtësisë, i cili është një institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Duke qenë se neni 147/d i Kushtetutës parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, KLGJ ka qënë në pamundësi për zhvillimin e proceduarave dhe vendosjen e masave disiplinore gjatë vitit të parë të funksionimit. Gjatë vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021, KLGJ në bashkëpunim me ILD, ka zhvilluar 3 procese disiplinore duke vendosur masën disiplinore shkarkim nga detyra, për tre gjyqtarë. Aktualisht, pranë Këshillit nuk ka asnjë kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. Vendimet e dhënies së masës disiplinore për tre gjyqtarët, gjenden në linkun e mëposhtëm:

<http://klgj.al/akte-administrative-individuale/>

Bazuar në dispozitat kushtetuese të mësipërme, KLGJ nuk mund të verifikojë kallëzimet apo të kryejë veprimtarinë e inspektimit për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, pasi nuk ka kompetencë. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk bën kërkesë për të nisur procedim disiplinor ndaj magjistratëve, por shqyrton në çdo rast kërkesat e ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në çdo rast që Këshilli vihet në dijeni përmes denoncimeve/ankimeve për veprimtari në kundërshtim me ligjin të gjyqtarëve, informon palën e interesuar për sferën e kompetencave të veta dhe e orienton t'i drejtohet organeve kompetente.

Në kuptim të nenit 8 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk ka asnjë rast të papajtueshmërisë ambientale. Sa i përket kërcënimeve, Këshilli në çdo rast që ka marrë dijeni, ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në asnjë rast nuk është cenuar vendimmarrja e gjyqtarëve për shkak të kërcënimeve gjatë ushtrimit të detyrës.

Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, shprehim gatishmërinë për t’ju përcjellë çdo informacion që ju nevojitet për realizimin e misionit tuaj fisnik për informimin e publikut, në format shkresor. Neni 14§3 i ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, sanksionon se informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik, prandaj informacioni ju përcillet në format shkresor, pasi ligji nuk parashikon detyrimin për të dhënë intervistë. Mbetemi kurdoherë të gatshëm për të përcjellë çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm në përputhje me ligjin, në funksion të rritjes së transparencës së sistemit gjyqësor dhe informimit të publikut.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**RUDIN BAQLI**

Konceptoi: E. Kuçi  
Pranoi/Miratoi: V. Kaloshi  
Konfirmoi: R. Baqli

5